



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 23.02.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy **kërkesave për ri-shqyrtim** të datës 23.02.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **LIMIT PROJECT SH.P.K** nga Drenasi dhe **RIO PLUS SH.P.K.** nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohen**, si te jashtafatshme kërkesat për rishqyrtim e OE **LIMIT PROJECT SH.P.K** dhe **RIO PLUS SH.P.K.** te datës 23.02.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontrate, të datës 08.01.2024 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor.
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatorët Ekonomik **LIMIT PROJECT SH.P.K** dhe **RIO PLUS SH.P.K.** me datën 23.02.2024 kanë parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 23.02.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, para 3. i cili thekson:

“3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

4.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

Operatori Ekonomik ankimor ka dorëzuar Kërkesen për rishqyrtim me date 23.02.2024, ndersa hapja e ofertave është me datën 27.02.2024.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që ka parashtruar ankesë pas afatit të fundit për dorëzim të ofertave.

Nenin 60.1(b) i Rregullave të prokurimit publik

Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0)

Nenin 63.2 i Rregullave të prokurimit publik

Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtror një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

Do të thote, data 23.02.2024, sipas 63.2 është dita (0), 24 shkurt është dita 1, 25 shkurt është dita 2, 26 shkurt është dita 3, 27 shkurt është dita (0) ne përputhje me nenin 60.1(b).

AK hedh poshte ankesen e parashtrua ne perrputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen percakton se:

Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.

Shih interpretimin e publikuar nga KRPP-ja me numer rendor 35 -rreth kalkulimit të afateve kohore për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim.

35. 04.12.2023 Si të kalkulohet afati kohor për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar lidhur me kalkulimin e afatit kohor për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim, KRPP ofron interpretimin ligjor, si në vijim:

Rregulla për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së përcaktojnë neni 108/A i LPP-së dhe neni 60 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (në tekstin e mëtejshëm “RRPP”).

Neni 60.1 i RRPP përcakton:

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “ kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

b) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).

c) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin e AK për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) për anulim të procedurës së prokurimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK është dita (0).

Kalkulimin e afateve kohore të përcaktuar me këtë ligj, e rregullon neni 5 i LPP-së.

Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni përcaktojnë:

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

2. Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj".

Pra, sipas paragrafit 1 të nenit 5 të LPP-së, afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe përfundojnë në një ditë pune. Sipas këtij paragrafi dhe në shtjellim të më tejme, ditë pune llogariten nga e hëna deri të premten, ndërsa koha zyrtare e punës llogaritet nga 8:00-16:00. Në këtë kontest, afatet kohore për parashtrim të Kërkesës për rishqyrtim kalkuloohen në këtë mënyrë:

1. Në përputhje me nenin 60.1, a) të RRPP, në rast se AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë, dita e fundit e dorëzimit të ofertave është dita "zero" e pesë ditëve të afatit ankimor në AK dhe ky afat fillon të kalkulohet në mënyrë retroaktive. Për shembull: Nëse Njoftimi për Kontratë apo dokumentet e tenderit janë publikuar (janë ngritë në sistem) me datë 05.10.2023 ndërsa afati i fundit për dorëzimin e ofertave është caktuar me datë 15.11.2023. Afati fillon të kalkulohet në mënyrë retroaktive duke filluar nga dita e dorëzimit të ofertave: 14, 13, 12, 11, 10 dhe rrjedhimisht afati i fundit kur një OE mund të parashtrorë kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së është data 09.11.2023 deri në ora 16:00. Pra në këtë rast, OE mund të parashtrorë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë e deri me datë 09.11.2023 para orës 16:00.

2. Në përputhje me nenin 60.1, b) të RRPP Në rast se AK ka publikuar në platformën elektronike të prokurimit publik B58 "Njoftimin mbi Vendimin e AK-së", data e publikimit të këtij njoftimi është dita "zero" e pesë (5) ditëve për parashtrimin e një Kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Për shembull: Nëse B58 "Njoftimi mbi vendimin e AK-së" është publikuar me datë 20.10.2023 para orës 16:00. Afati fillon të kalkulohet nga dita e nesërme e publikimit: 21. 22. 23. 24. 25 dhe rrjedhimisht afati i fundit për të parashtruar Kërkesën për rishqyrtim është data 25.10.2023 deri në ora 16:00. Pra nëse AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e AK-së në ditën e premte, dita e premte është dita "0" e pesë (5) ditëve për Kërkesë për rishqyrtim në AK. Pra afati i fundit për të parashtruar kërkesën është dita e Mërkurë deri në ora 16:00.

3. Në përputhje me nenin 60.1, c) të RRPP, në rast se AK ka publikuar në platformën elektronike të prokurimit publik Njoftimin mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e procedurës. Data e publikimit të këtij njoftimi është dita "zero" e pesë (5) ditëve për të parashtruar Kërkesën për rishqyrtim. Për shembull: Nëse Njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e procedurës është publikuar me datë 25.10.2023. Afati i fundit

nga data e publikimit të këtij njoftimi është 30.10.2023 deri në ora 16:00 për të parashtruar një kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-së.

Për të gjitha rastet "Njoftimi mbi vendimin e AK-së" nënkupton Njoftimin e ngritur në sistem nga AK para orës 16:00 në mënyrë që ajo ditë të konsiderohet dita "zero" e pesë (5) ditëve për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim. Operatorët Ekonomik dhe/ose palët e interesuara do të konsiderohen "Të njoftuar" nga momenti kur AK e ngritë në sistem cilin do njoftim lidhur me aktivitetin në fjalë. Çdo Kërkesë e parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 60 të RRPP, do të refuzohet nga AK dhe për të njëjtën ankesa nuk do të merret në shqyrtim nga OSHP.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. LIMIT PROJECT SHPK
2. RIO PLUS SH.P.K.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit